



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1452, datë 22.11.2010

Për

“Shqyrtimin e Ankimit Administrativ të Vodafone Albania sh.a. me nr. 3309/2 prot, datë 17.11.2010 për shpalljen absolutisht të pavlefshëm ose revokimin e VKD nr. 1437, datë 3.11.2010, “Per disa ndryshime në VKD nr. 1347, date 23.7.2010, “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a., të aktit administrativ VKD nr. 1211, datë 31.3.2010, të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me Fuqi te Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës __.11. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Shqyrtimin e Ankimit Administrativ të Vodafone Albania sh.a. me nr. 3309/2 prot, datë 17.11.2010 për shpalljen absolutisht të pavlefshëm ose revokimin e VKD nr. 1437, datë 3.11.2010, “Per disa ndryshime në VKD nr. 1347, date 23.7.2010, “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a., të aktit administrativ VKD nr. 1211, datë 31.3.2010, të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me Fuqi te Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.

BAZA LIGJORE:

1. Germa II) e nenit 8, neni 55 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**K.Pr.A**)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (**Rregullorja e Brendshme**);
4. Vendimi nr.1437, datë 3.11.2010, “Per disa ndryshime ne VKD nr. 1347, date 23.7.2010, “Për shqyrtimin e ankimit administrativ te Vodafone Albania sh.a., të aktit administrativ VKD nr. 1211, date 31.3.2010, te AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me Fuqi te Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**Vendimi**);

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Vodafone Albania nr. 3309/2 prot, datë 17.11.2010 “Dërgim i Ankimit Administrativ të Vodafone Albania sh.a. “Për shpalljen absolutisht të pavlefshëm ose revokimin e VKD nr. 1437, date 3.11.2010, “Per disa ndryshime ne VKD nr. 1347, date 23.7.2010, “Për shqyrtimin e ankimit administrativ te Vodafone Albania sh.a., të aktit administrativ VKD nr. 1211, date 31.3.2010, te AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me Fuqi te Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”. (**Ankim Administrativ**);
2. **Vendim i KD nr. 1347** date 23.07.2010 për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a. per ndryshimin, te Aktit Administrativ, Vendim nr.1211, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Vodafone Albania sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**Vendimi**);
3. Projektvendim i KD të AKEP “Për Shqyrtimin e Ankimit Administrativ të Vodafone Albania sh.a. me nr. 3309/2 prot, datë 17.11.2010 i AKEP “Për shpalljen absolutisht të pavlefshëm ose revokimin e VKD nr. 1437, date 3.11.2010, “Per disa ndryshime ne VKD nr. 1347, date 23.7.2010, “Për shqyrtimin e ankimit administrativ te Vodafone Albania sh.a., të aktit administrativ VKD nr. 1211, date 31.3.2010, te AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me Fuqi te Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**Projektvendimi**);
4. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);
si dhe,
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Vodafon Albania sh.a brënda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 140 të ligjit nr.8485, ka bërë ankim administrativ AKEP “Për shpalljen absolutisht të pavlefshëm ose revokimin e VKD nr. 1437, date 3.11.2010, “Për disa ndryshime në VKD nr. 1347, date 23.7.2010, “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a., të aktit administrativ VKD nr. 1211, date 31.3.2010, të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;

Vodafon Albania sh.a me shkresën nr. extra Prot, datë 15.11.2010 (AKEP: nr. 3309/2 Prot, datë 17.11.2010, konsideron se:

1. Vendimi nr. 1437 është absolutisht i pavlefshëm sepse është marrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ligji, pasi:
 - a. Teksti i Vendimit nr. 1437 i komunikuar nga AKEP mban vetem nënshkrimin e Kryetarit;
 - b. Gërma c) e nenit 116 i Ligj nr. 8485 K.Pr.A parashikon se aktet administrative janë absolutisht të pavlefshme kur janë nxjerë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji;
2. Vendimi është marrë në shkelje flagrante të të drejtave procedurale dhe kushtetuese të Vodafone Albania në një proces administrativ, për arsyet si më poshtë vijon:
 - a. AKEP ka shkelur nenet 44, 47, dhe 51 të K.Pr.A, nenet 6 dhe 7 të dokumentit “Rregullore e për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” miratuar me VKD nr. 1296 dt. 11.06.2010 të AKEP;
 - b. Mungesa e njoftimit të këtij procedimi nga AKEP ka çuar në shkelje të rëndë të së drejtës së Vodafone Albania për të marrë pjesë në procedimin administrativ;
 - c. AKEP ka marrë në shqyrtim kërkesat e sipërmarrësve si Albtelecom sh.a, Abcom sh.p.k dhe Neofone sh.p.k pa i’u njoftuar Vodafone Albania këto pretendime;
 - d. Vodafone Albania nuk i është kërkuar nga AKEP që të paraqesë pretendimet për t’i dhenë mundësi që të bëjë prapësime dhe të japë kundërgargumenta;
 - e. Neni 36 i Ligj. 9918 përcakton se masat rregulluese në bazë të analizës së tregut për një operator me fuqi të ndjeshme në treg mund të merren vetem pas këshillimit publik;
3. Vendimi nr. 1347 ka mangësi serioze në përmbajtjen e tij;
4. AKEP, nuk ka arsyetuar nga ana ligjore dhe rregullatore se pse vendoset masa e rregullimit të tarifave të terminimit të trafikut ndërkombëtar për Vodafone Albania sh.a;
5. Për sa më sipër Vodafone Albania sh.a kërkon “Shpalljen absolutisht të pavlefshëm ose revokimin e VKD nr. 1437, datë 03.11.2010, “Për disa ndryshime në VKD nr. 1347, date 23.7.2010, “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të

Vodafone Albania sh.a., të aktit administrativ VKD nr. 1211, date 31.3.2010, të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me Fuqi te Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;

6. Kërkësë të cilën e mbështet në nenet 45, 53, dhe 57 të Ligj nr. 9918, dt. 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 44, 47, 53, 93, 94, 116, 117, 118, 109, 137, 138.1 dhe 140 të K.Pr.A, si dhe në pika 6.2, 7.5 e VKD nr. 1296, dt. 11.06.2010 “Rregullore për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” të AKEP;
- II. AKEP, bazuar në shqyrtimin e pretendimeve të ankimit administrativë të Sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., në lidhje me Vendimin nr. 1437, datë 03.11.2010 të AKEP, gjykon se:
1. Pretendimet e ngritura nga Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a në lidhje me rregullsinë dhe ligjshmërine formale të kopjes së komunikuar palës Vodafone Albania sh.a të VKD nr. 1437, datë 03.11.2010 me shkresen nr. 3309/1, datë 10.11.2010 referuar nënshkrimit nga ana e anëtarëve të KD të pranishëm në mbledhjen e radhës parashtrijmë se, AKEP si një autoritet publik me organ drejtues të një natyre kolegjiale funksionon dhe merr vendimet në bazë të ligj. nr. 9918, datë 19.05.2008 (n 114,n 115), ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” , si dhe rregullores së brendshme të miratuar nga ai vet. Ne këtë mënyrë Vendimi nr. 1437 është marrë duke u votuar nga kuorumi i nevojshëm i votave të anëtarëve të KD-së reflektuar këto në dokumentin “*Procesverbal i Mbledhjes së KD datë 03.11.2010*” duke urdhëruar zbardhjen dhe njoftimin e tij palës së interesit nëpërmjet një kopje të sigluar nga drejtuesi i organit kolegjial në cilësinë e Kryetarit të KD-së.
 2. Arsyetimi i përdorur në ankimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a për flagrancën procedurale të shqyrtimit të ankimeve administrative të sipërmarrësve Abcom sh.p.k, Albtelecom sh.a dhe Neofone sh.p.k, të trajtuara dhe cituar nga AKEP në VKD nr. 1437, nën argumentin se për arsye të provave të reja mbi çështjen , palës së interesuar Vodafone Albania duhej t’i jepej mundësia e dëgjimit përpara marrjes së vendimit që sipas Vodafone Al ka shkelur të drejtat procedurale dhe kushtetuese theksojmë se, AKEP është organi i administratës publike i cili gëzon personalitet juridik të posaçëm për të ushtruar me ose pa iniciativen e tij (kryesisht) brënda të gjitha tagreve juridike materiale, procedurale dhe për të çmuar administrativisht detyrën e shqyrtimit të ankesave administrative të sipërmarrësve të autorizuar nga ai vet. Në këtë mënyrë marrja e Vendimit nr. 1437 datë 3.11.2010 nga Këshilli Drejtues ishte rezultat i vlerësimit të situatës juridike dhe tregëtare të palëve në qarkullimin civil të fushës së komunikimeve elektronike duke u gjendur në një kaos mosmarrëveshesh të natyrës civile tregëtare manifestuar me mos realizim të Interkoneksionit nga ana e subjektit mbartës i detyrimit i cili tarifën e tërminit për thirrjet ndërkombëtare edhe pse të parashikuar nga AKEP me VKD nr. 1347 “*në terma komerciale*” sërish nga natyra e mosmarrëveshjeve të depozituara në autoritet, krijoi bindjen e KD-se duke konstatuar se Vodafone Al sh.a nuk e kishte negociuar tarifën e këtyre thirrjeve me sipërmarrësit e interesuar në mënyrë transparente duke i’u dhënë atyre shpjegime dhe argumenta për nivelin e saj, me qëllim që të vërtetonte

se ishte një tarifë e arsyeshme, e orientuar drejt kostos, jo abusive, konkurruese dhe e pranueshme nga palët e interesuara.

Gjithashtu AKEP, në mirëbesim e gjykoj si të mjaftueshme kohën që kishin në dispozicion palët afati 3 mujor, për të negociuar dhe për të aritur konsensusin e ofrimit të shërbimeve të tyre me tarifa tregëtare të arsyeshme dhe të pranueshme.

3. Pretendimi i ngritur nga Vodafone Al në lidhje me mungesën e njoftimit për fillimin e procedimit administrativë mes palëve, AKEP spjeron se nuk ka marrë asnjë vendim për fillim të procedimit administrativë për zgjidhje mosmarreveshje midis palëve bazuar në Rregulloren për procedurat e zgjidhjes së mosmarreveshjeve, pasi vetem në këtë rast autoritetit i lind detyrimi i njoftimit të palëve për procedurën administrative të iniciuar, ndërsa VKD nr. 1437, është një akt ndryshues i cili trajton ankesat e tre sipermarrësve në mosmarreveshje me Vodafone Al për shkak të interpretimit të njeanshem të termit “tarifa komerciale” të parashikuar në VKD nr. 1347, duke u përfshire në trajtesat administrative brënda harkut kohor një mujor (K.Pr.A).
4. AKEP marrë shkas nga mosmarreveshjet e sipermarrësve në treg, pas depozitimit të kërkesave të tyre ankimore, çmoi ndërhyrjen diskrecionale të tij duke ushtruar të drejtën e ndryshimit të pjesshëm të aktit administrative të nxjerrë nga vet ai.
5. Pretendimi procedural i Vodafone Al sh.a për realizimin e procedurës së këshillimit me publikun për vendime me rëndësi dhe efekte për palët përpara nxjerrjes së VKD nr. 1437, sqarojmë se, AKEP kryen këshillim me publikun jo në rastin e shqyrtimit të ankimeve administrative, apo procesit të zgjidhjes së mosmarreveshjeve por gjatë procesit të përgatitjes së dokumenteve rregullatore për tregun e KE dhe përpara marrjes së vendimit për miratimin e tyre, kur ato kanë një ndikim të ndjeshëm në treg atëhere këto dokumente i nënshtrohen procesit të këshillimit publik .
6. AKEP gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesave administrative të sipermarrësve në rastet kur çmon se një akt administrativ i nxjerrë prej tij mund të çënojë të drejtat dhe interesat e një pale të tretë, detyrimisht fton palën për të marrë pjesë në shqyrtimin e ankimit dhe për t’u dëgjuar, ndërsa duke u ballafaquar me një situatë të krijuar nga sjellje jo ligjore të Vodafone AL sh.a duke vepruar në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare në treg me ndërprerjen e ofrimit të shërbimit të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare ndaj tre sipermarrësve me sipër cituar për të parandaluar cënimin e mëtejshëm të detyrimeve të përcaktuara nga AKEP me vendimet nr. 1211 dhe nr. 1347, vendosi të marrë situatën nën kontroll për sa i përket rregullimit të tarifave për thirrjet ndërkombëtare, të keqkuptuara nga Vodafone AL sh.a me rregullimin komercial të tyre.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Duke vlerësuar se pretendimet e sipermarrësit Vodafone Al sh.a janë të pabazuara dhe nuk qëndrojnë, bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të rrëzojë kërkesën ankimore nr. 3309/2 prot, datë 17.11.2010 të Vodafone Albania sh.a.
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARE:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**